

L I G J
Nr.7922, datë 19.4.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7537, DATË 17.12.1991 “PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E PROCEDURËS CIVILE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Komisionit të Ligjeve,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin e Procedurës Civile neni 62 ndryshohet si vijon:

“Gjykata e rrethit shqyrton në shkallë të parë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar e dy ndihmësgjyqtarë këto çështje civile:

- Paditë për njohjen dhe kërkimin e pronësisë dhe të drejtave reale mbi pronësinë.
 - Paditë për pushimin e cënimit të pronësisë (mohuese) dhe për kallzimin e një punimi të ri dhe të një dëmi të mundshëm.
 - Paditë posedimore.
 - Kërkesat për miratimin e shoqatave, për likuidimin e personit juridik dhe paditë kundër një veprimtarie të fondacionit.
 - Paditë për kërkimin e së drejtës së emrit.
 - Paditë për pavlefshmërinë e një veprimi juridik.
 - Paditë që kanë lidhje me administrimin e bashkëpronësisë.
 - Paditë për pavlefshmërinë e testamentit, kërkimin dhe pjesëtimin e trashëgimit.
 - Paditë që rrjedhin nga mosekzekutimi ose ekzekutimi jo në mënyrën e plotë të detyrimeve, për shpërblimin e dëmit, begatimin pa shkak, e pagimin e padetyruar.
 - Paditë për heqjen e hipotekës, pengut e dorëzarisë, kur janë përdorur si mjete për ekzekutimin e detyrimeve.
 - Paditë për pavlefshmërinë dhe zgjidhjen e martesës, për birësimin dhe për njohjen e kundërshtimin e atësisë e amësisë.
 - Paditë për largimin ose transferimin nga puna dhe për kërkimin e shpërblimit të rrjedhur nga marrëdhëniet e punës dhe nga sigurimet shoqërore.
 - Paditë për kundërshtimin e urdhërit administrativ.
- Çështjet civile të tjera shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1094, datë 4.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha